

V E N D I M
Nr.46, datë 28.01.1999

“NË EMËR TË POPULLIT”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Avni Shehu	Kryetar
Agim Shkupi	Anëtar
Natasha Sheshi	“
Vitore Tusha	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloçi	“
Agim Gjoleka	“
Metush Saraçi	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	“
Bashkim Caka	“
Tefta Zaka	“

Në seancën gjyqësore të datës 28.01. 1999 mori në shqyrtim çështjen penale nr. 96/1 që i përket :

I PANDEHUR: Altin Zeneli

AKUZA : Vjedhje me dhunë neni 139 K. Penal

Gjykata e rrethit Sarandë me vendimin nr. 85, datë 28.08. 1999 ka vendosur:

- Të vleftësojë si të ligjshme urdhërin e ndalimit të shtetasit Altin Zeneli.

- Të caktojë si masë sigurimi ndaj shtetasit Altin Zeneli “Arrest në burg me afat 15 ditë”.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 21 datë 9.9. 1998 ka vendosur :

Lënien në fuqi të vendimit nr. 85 datë 28.8.1998 të gjykatës së rrethit Sarandë duke miratuar “Arrest në burg” me afat 15 ditë për të pandehurin Altin Zeneli.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka bërë rekurs prokurori pranë kësaj gjykate duke parashtruar këto shkaqe:

Vendimi është i pabazuar në ligj. neni 244/1 i K.Pr.Penale ngarkon organin e prokurorisë për të paraqitur kërkesën lidhur me caktimin e masës së sigurimit.

Ndryshimi i bërë nga gjykata është lajthitje e nenit 280/2 të K. Pr. Penale .

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e anëtarit Vladimir Metani dhe prokuroren V. Ahmetaj e cila shprehu mendimin se është prokurori ai që përcakton nevojën e llojin e kërkesës.

V Ë R E N:

Kolegji Penal i kësaj gjykate me vendimin e tij datë 18.11.1998 ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate. Në vendimin e tij Kolegji kërkon për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore nëse: a) Gjykata cakton atë masë sigurimi që kërkohet nga organi i procedimit (prokurori).

b) Gjykata është e lirë të caktojë atë masë sigurimi që çmon se përputhet me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit të saj.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pasi shqyrtuan çështjen në tërësi arritën në përfundimin se :

Sipas pikës 1 të nenit 244 të K.Pr.Penale organi procedues (prokurori) me kërkesën

e tij vë në lëvizje gjykatën për të vendosur masat e sigurimit.

Është kjo e fundit që në përputhje me kërkesat e neneve 228 e 229 të K.Pr.Penale cakton masën e sigurimit personal. Në pikën 1 të nenit 229 të K.Pr. Penale thuhet : Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.

Të dyja gjykatat si ajo e rrethit Sarandë dhe ajo e Apelit Gjirokastrë kanë vepruar drejtë në përputhje me kërkesat e neneve të sipërcituara dhe nuk kanë asnjë "lajthitje" të nenit 260 të K.Pr.Penale siç thuhet në rekursin e prokurorit .

Ky nen ka të bëjë e do të zbatohet në rastin kur është caktuar masa e sigurimit dhe kërkohet revokimi ose zëvendësimi i saj, por dhe në këtë rast është gjykata ajo që çmon e vendos.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 441 germa "e" të K.Pr.Penale

V E N D O S Ë N:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 21 datë 09.09.1998 të gjykatës së Apelit Gjirokastrë